



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**U D H Ë Z I M
Nr. 241 Datë 21.11.2005**

PËR

**RREGJISTRIMIN E NJOFTIMIT TË VEPRËS PENALE DHE TË EMRIT TË
PERSONIT QË I ATRIBUOHET VEPRA PENALE**

Me synim,

- për te normuar rregjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale,
- për të shmangur praktikën e gabuar dhe për të vendosur rregulla të njëjta për të gjitha Prokuroritë e shkallës së parë

Ne mbështetje, të nenit 24 pika 4, 287 e vijues të K. Pr. Penale dhe nenit 8 pika 2 të ligjit Nr. 8737 datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë",

U D H Ë Z O J :

1 .Rregjistrimi i njoftimit të veprës penale, si dhe regjistrimi i emrit të personit që i atribuohet vepra penale të kryhen me urdhër të vecantë të arsyetuar, sipas modelit bashkëlidhur. Urdhëri i dërgohet për veprim prokurorit ose punonjësit që mban regjistrin e procedimeve, i cili menjëherë bën shënimet përkatëse të regjistër.

2.Prokurori urdhëron të shënohet në regjistër njoftimi për veprën penale pasi verifikon dhe vlerëson aktet që ka rre dispozion, për ekzistencën e elementëve thelbësore të faktit dhe të elementëve të figurës së veprës penale.

2.1 Në rastet kur me gjendjen e akteve prokurori vlerëson se ekzistojnë rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit, vendos mosfillimin e procedimit, por jo më vonë se 10 ditë nga mbërritja e kallximit apo referimit të veprës penale. Gjatë kësaj periudhe nxitim të bëhet një minimum verifikimesh nëse ka nevojë për një gjë të tillë, në të kundërt vendoset regjistrimi i procedimit.

3. Në rastet kur materjali i referimit të veprës penale nga policia gjyqësore shoqërohet, me akte procedurale që përmbajnë atribuime për person konkret, prokurori urdhëron si rregjistrimin e ooftimit të veprës penale, ashtu dhe regjistrimin e emrit të personit.

3.1. Në rastet e kallximeve, fillimisht regjistrohet njoftimi për veprën penale nëse janë kushtet e pikës 2. Pasi administrohen akte procedurale që i atribuojnë kryerjen e veprës penale personit, prokurori merr vendim për regjistrimin e emrit. Përmëndja e emrit të një personi në një kalbdm nuk mund të shërbej për regjistrimin e menjëhershëm të emrit në regjistër, pa u administruar më parë akte procedurale në të cilat gjendea atribuime për personin konkret,

4. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen të gjithë prokurorët, ndërsa për te kontrolluar zbatimin e tij ngarkohen drejtuesit e të gjitha niveleve të prokurorive.

5. Mospërmbushja e detyrave të përcaktuara në këtë udhëzim, përbën shkelje të disiplinës në punë.

6. Me këtë udhëzim të njihen të gjithë prokurorët dhe drejtuesit e Prokurive të të gjitha niveleve dhe punonjësit e caktuar për rmbajtjen e regjistrit të procedimeve.

7. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PERGJITHSHEM

THEODHORI SOLLAKU